

ISO 15270 do të ndihmojë rigjenerimin e materialeve plastike dhe riciklimin në nivel ndërkombëtar.



2008-07-04

Një Standard i Ri i Organizatës Ndërkombëtare të Standardizimit (ISO) do të ndihmojë në marrjen fund të vështirësive të tregut ndërkombëtar për rigjenerimin dhe riciklimin e materialeve plastike. Për arsye se produktet plastike tregtohen në mbarë botën dhe shumë nga materiali bazë plastik i prodhuar nga kompanitë dhe përdoruesit industriale janë kompani multinacionale, ardhja e **ISO 15270:2008, *Plastika – Udhëzues për rigjenerimin dhe riciklimin e mbetjeve plastike*** - është

veçanërisht një mundësi për t'u shfrytëzuar.

ISO 15270:2008 ka për qëllim të ndihmojë të gjithë partnerët e industrisë së plastikës në zhvillimin e:

- një infrastrukture globale të qëndrueshme për rigjenerimin dhe riciklimin e plastikës;
- një tregu të qëndrueshëm për materialet plastike të rigjenerueshme dhe për prodhimin e derivateve të tyre.

Materialet plastike për rigjenerim mund të merren nga burime të ndryshme dhe tregjet më të mëdha për plastikën janë paketi, produktet e ndërtimit, produktet elektrike dhe elektronike, produktet për transportimin, dhe artikuj të ndryshëm për përdorim shtëpiak, etj.

ISO 15270:2008 krijon opsione të ndryshme për riciklimin e mbetjeve plastike që vijnë nga burime industriale (përpara se t'i marrë konsumatori) dhe nga burime post-konsumator (mbas përdorimit nga konsumatori). Standardi do të ndihmojë në zgjedhjen e metodikave dhe proceseve për menaxhimin e plastikës mbas përdorimit, dhe që mund të përdoren në mënyra dhe strategji të ndryshme.

Në përgjithësi, teknologjitë e rigjenerimit të plastikës mund të ndahen në dy nivele:

- materiale rigjeneruese: riciklimi mekanik, kimik ose materiali stok për riciklimin dhe riciklimi organik ose biologjik;
- rigjenerimi i energjisë në formën e nxehtësisë, avullit ose gjenerimi i elektricitetit duke përdorur mbetjet plastike si zëvendësues i lëndëve të para të zjarrit.

Ky Standard Ndërkombëtar gjithashtu vendos kërkesat e cilësisë që duhet të konsiderohen në të gjitha hapat e procesit të rigjenerimit. Përzgjedhja e çdo njërit nga opsionet e disponueshme të riciklimit duhet të bazohet në përputhshmërinë me kërkesat në vijim:

- nevoja për të minimizuar impaktin e kundërt në mjedis
- demonstrimin me parë të vijueshmërisë komerciale të qëndrueshme
- sigurimin e aksesit tek sistemet e grumbullimit dhe kontrollit të cilësisë.

ISO 15270:2008 gjithashtu siguron rekomandimet për përfshirjen në standardet e materialeve, në standardet e provave dhe specifikimet e produkteve. Për rrjedhojë, fazat e procesit, kërkesat, rekomandimet dhe terminologjia e dhëna në këtë standard kanë për qëllim të jenë të aplikueshme për të gjithë.

Dr. Michael M. Fisher, Kryetar i Komitetit Teknik ISO/TC 61 *Plastika*, komiteti që ka hartuar standardin, bën komenti e tij, “aksesi në tregjet për materialet e rigjenerueshme ose për energjinë është një problem i rëndësishëm që kërkon të konsiderohet. Ekziston tashmë tregu ndërkombëtar në produktet fundore për qëllimin e riciklimit të komponentëve plastike dhe ISO 15270:2008 synon të sigurojë një burim të çmueshëm dhe që merr përkatësi globale, pavarësisht së cilën pjesë apo kuadër ligjor në lidhje me rigjenerimin dhe riciklimin e plastikës mbulon aplikimi i tij.”

ISO 15270:2008, ***Plastika – Udhëzues për rigjenerimin dhe riciklimin e mbetjeve plastike*** kushton 2677 lekë për jobashkëpunëtorë dhe 1338 lekë për bashkëpunëtorë. Standardi është i vlefshëm si Standard Shqiptar (S SH), duke qenë identik me origjinalin, dhe mund ta gjeni në zyrat e DPS-së, në adresën:

Rruga: "Mine Peza", Nr. 143/3,
1014 -Tiranë, Shqipëri.
Kutia Postare 98
Tel: + 355 (04) 222 62 55
Fax: + 355 (04) 224 71 77
E-mail: info@dps.gov.al
Web: www.dps.gov.al